



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Nr. ____ Prot

Korçë, më 28.06.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (paraparak)

Date 28.06.2024

Drejtuar: **Shoqërisë "I.C.C GROUP" sh.p.k** adresa: TIRANE Njesia bashkiake Nr.4, Rruga 5Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-08316-06-06-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **"Rehabilitimi i Qendrës Rinore Korçë "**

Afati: **90 ditë kalendarike**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr 30, Date 10.06.2024**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria „I.C.C GROUP“ sh.p.k, NIPT L51308006A me vleren:

6.902.498 (gjashtë milion e nëntëqind e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

2. Shoqeria "NIKA" shpk, NIPT J76705047U me vleren:

7.395.961,70 (shtatë milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një presje shtatë) lekë pa tvsh.

3. Shoqëria “RSM COMPANY” me Nr Biznesi 810802422 me vleren:

7.313.654 (shtatë milion e treqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

4. Shoqëria “J O G I” shpk, me NIPT J63229478K me vleren:

7.499.432,50 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e dy presje pesë) lekë pa tvsh.

5. Shoqëria “S P E K T R I” shpk, me NIPT J62903555F me vleren:

7.976.870 (shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.

6. Shoqëria “XHENGO” shpk, me NIPT J64103171M me vleren:

8.202.465 (tetë milion e dyqind e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

7. Shoqëria “GLAVENICA” shpk, me NIPT K17710805A, me vleren:

8.365.727 (tetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë) lekë pa tvsh.

8. Shoqëria “MENI” shpk, me NIPT J61909018W me vleren:

8.436.540 (tetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet) lekë pa tvsh..

9. Shoqëria “AVDULI” shpk, me NIPT J66703306O me vleren:

8.571.215 (tetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

10. Shoqëria “INA” shpk, me NIPT J61814009W, me vleren:

8.969.130,2 (tetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë presje dy) lekë, pa tvsh.

11. Shoqëria “ASI INVEST” shpk, me NIPT M01927023H me vleren:

9.558.012 (nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dymbëdhjetë) lekë pa, tvsh.
(vlëra mbas korrigjimit)

❖ **Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Shoqëria “RSM COMPANY” me Nr Biznesi 810802422

Oferta refuzohet për arsye se:

1. Nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale, pika 2.2.2 ku është përcaktuar shprehimisht se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P – 3	A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S- 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S - 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
N.S – 14	A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Konkretisht nuk është paraqitur licenca profesionale e ofertuesit, shoqërisë “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company d.h.sh L04803001U “RSM COMPANY” shpk (mëma) Nr Biznesi 810802422”

2. Shoqëria “XHENGO ” shpk, me NIPT J64103171M,

Oferta refuzohet për arsye se:

Ofertuesi skualifikohet bazuar në nenin 82 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Konkretisht:

Në ofertën e paraqitur nga ofertuesi rezultoi se është bërë gabim në llogaritjen e vlerës me tvsh të shënuar në shtojcën 1 Formulari i ofertës dhe shtojcën 2 “Lista e çmimeve”

Vlera totale e ofertës me tvsh mbas korigjimit rezulton : Shuma e ndërtimit (me tvsh) 6.400.157+ Shuma Pajisje 2.869.000=9.269.157 lek

Nga ofertuesi vlera totale e ofertës me TVSH është shënuar 6.400.157 lek në shtojcën 1 Formulari i ofertës dhe 8.202.465 lek në shtojcën 2 “Lista e çmimeve”

3. Shoqëria “ASI INVEST ”shpk, me NIPT M01927023H ,

Oferta refuzohet për arsye se:

1. -Ofertuesi skualifikohet bazuar në nenin 82 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Në ofertën e paraqitur nga ofertuesi rezultoi se është bërë gabim në llogaritjen e vlerës pa tvsh të shënuar në shtojcën 1 Formulari i ofertës.

Në dokumentat e tenderit në shtojcën 1 Formulari i ofertës është vendosur shënimi: “**Tek cmimi total i ofertes pa TVSH ofertuesit duhet të shenojnë vlerën që del nga shuma e punimeve ndërtimore pa tvsh+shumen e pajisjeve.**”

Bazuar në sa më sipër, nga mbledhja e shumës të punimeve ndërtimore pa tvsh (5.663.312) me shumen e pajisjeve (3.894.700) rezulton vlera 9.558.012 lek pa tvsh dhe jo 8.908.895 lek pa tvsh siç është shënuar nga ofertuesi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine **“I.C.C GROUP”sh.p.k** adresa: **TIRANE Njesia bashkiake Nr.4, Rruga 5Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21**, se oferta e paraqitur me vlerë totale **6.902.498 (gjashtë milion e nëntëqind e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**ZV/KRYETARE
BESA SPAHO**